

VENDIM
Nr.863, datë 17.12.2004

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “ PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS TË
PUNONJËSVE MËSIMORË , NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave c” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Pagat e punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar rriten mesatarisht në masën 8 për qind.

b) Lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë” zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Lidhja nr.2 zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2004 e në vazhdim, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe efektet fillojnë nga data 1 nëntor 2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STRUKTURA E PAGES PER PUNONJESIT MESIMORE

EMERTIMI		PAGA MUJORE				
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E PROFESIONIT	
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjeter si (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Totali
		1	2	3	4	5 (1+2+3+4)
1	Drejtor i shkolles se mesme. Pergjegjes poligoni . Drejtor i institutit te nxenesve qe nuk shikojne. Drejtor i institutit te nxenesve qe nuk degjojne. Drejtor ne shkollat me probleme te larta mendore. Drejtor i konvikteve.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	17147	
2	Zevendesdrejtor i shkolles se mesme. Pergjegjes i bazes prodhuese. Zevendesdrejtor institutit te nxenesve qe nuk shikojne. Zevendesdrejtor i institutit te nxenesve qe nuk degjojne. Zevendesdrejtor ne shkollat me probleme te larta mendore. Drejtor i Qendres Kulturore te Femijeve.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	14293	
3	Drejtor i shkolles 8-vjecare.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	13865	
4	Drejtor i shkolles fillore klasa I-IV-et. Pergjegjes (kryemesuesi) i shkolles me klase kolektive. Zevendesdrejtor i shkolles 8-vjecare. Pergjegjes sektori ne Qendren Kulturore te Femijeve.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	12010	
5	Drejtor i kopshtit me ushqim.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	10274	
6	Drejtor i kopshtit pa ushqim.	1	2% e	5 % e P.G	8552	

			P.G .	10% e P.G 20% e P. G		
7	Mesues ne shkollat e mesme. Mesues ne institutin e nxenesve qe nuk shikojne. Mesues ne institutin e nxenesve qe nuk degjojne. Mesues ne shkollat me Probleme te Larta Mendore.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	12234	
8	Mesues ne shkollat 8-vjeçare, klasa I-VIII. Edukator konvikti. Kujdestar konvikti. Instruktur ne Qendren Kulturore te Femijeve.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	9920	
9	Edukator ne kopesht femijesh.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	7194	
10	Mesues	2	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	9300	
11	Mesues	3	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	9300	
12	Edukator ne kopesht femijesh.	3	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	7674	
13	Edukator ne kopesht femijesh.	2	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P. G	7674	

LIDHJA NR.2

GRUPI	PAGA NË LEKË
1	9306
2	7300
3	6600
4	4500